



Bazuar në nenin 21 paragrafi 21.1 dhe 21.3 të Ligjit 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike dhe ne dispozitat e Statutit të NPL " Stacioni I Autobusëve " Sh.A. Prishtinë, pas përfundimit të procedurave të përzgjedhjes për pozitën e Punës Sekretar Korporativ sipas konkursit të rishpallur me nr.02/2024 datë 04.12.2024, Bordi I Drejtorëve mer këtë:

V E N D I M

- I. Znj. Bedrije Mjeku zgjedhet/emërohet Sekretare Korporative e NPL " Stacioni I Autobusëve" Sh.A.Prishtinë.
- II. E emëruara sipas pikës I të këtij vendimi themelon marrëdhënie pune me kohë të caktuar, për tre vite në NPL " Stacioni I Autobusëve" Sh.A.Prishtinë duke filluar nga data: 13.01.2025 deri me datë 12.01.2028.
- III. Me të emëruaren Znj. Bedrije Mjeku dhe NPL " Stacioni i Autobusëve" Sh.A.Prishtinë, lidhet kontrate mbi themelimin e marrëdhënies së punës me kohë të caktuar, për pozitën e punës, Sekretare në NPL "Stacioni i Autobusëve" Sh.A. Prishtinë, në harmoni me nenin 10 paragrafi 2.2 I Ligjit nr. 03/L – 212 të Punës dhe në harmoni me Ligjin për Ndërmarrjet Publike, Ligjin Për Shoqëritë Tregtare dhe Statutin e NPL " Stacioni I Autobusëve" Sh.A.Prishtinë.
- IV. Obligohet Zyra e Burimeve Njerëzore dhe personel, e ndërmarrjes të përgadis dhe përpiloj kontratën e punës sipas këtij vendimi.
- V. E emëruara sipas këtij vendimi, obligohet që brenda afatit ligjor, të bëjë deklarinimin e pasurisë në harmoni me ligjin përkatës për deklarinimin e pasurisë.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nëshkrimit nga Kryesuesi i Bordit .

Arsyetim

Bordi i Drejtorëve I NPL " Stacioni i Autobusëve" Sh.A.Prishtinë, duke u bazuar ne dispozitat e Ligjit për Ndërmarrje Publike, me datë 04.12.2024 rishpall konkurs publik për Sekretar korporativ në NPL "Stacioni I Autobusëve" Sh.A.Prishtinë.

Bordi i Drejtorëve, pas shqyrtimit të aplikacioneve dhe intervistimin e kandidatëve për poziten Sekretar Korporativ në NPL "Stacioni i Autobusëve" Sh.A.Prishtinë, konstatoi se rezultatet me të mira ka treguar kandidatja znj.Bedrije Mjeku, e cila ka arritur të grumbulloj numrin me të madh të pikëve.

Andaj, në bazë të rezultatit të vlerësuar, Bordi i Drejtorëve, për Sekretar Korporativ në NPL "Stacioni i Autobusëve" Sh.A.Prishtinë, të zgjedh/emëroj znj.Bedrije Mjeku, rrjedhimisht u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilla juridike: Kundër këtij vendimi palët e pakënaqura mund të paraqesin ankese tek Bordi i Drejtorëve në afat prej 8 ditësh nga dita e pranimt të këtij vendimi. Ndërsa ankesa nuk e pezullon zbatimin e këtij vendimi.

T'i dërgohet
1.x1. Të emëruares
1x1. BNJP
1.x1. Dep.Ekonomiko – financiar;
1.x1. Arkivit.

